



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Histori bërthamë

Varianti B

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	D	B	C	D	D	C	B	A	C

• *Pyetjet me zhvillim*

Pyetja 11

Model përgjigjeje

- Bashkimi i katër vilajeteve në një të vetëm.
- Formimi i gjyqeve, arkës dhe ushtrisë.
- Hapjen e shkollave shqipe.
- Taksat e shqiptarëve të shkonin për reformat në Shqipëri.
- Krijimi i qeverisë së përkohshme.

3 pikë Nëse shkruan tre nga kërkesat e Lidhjes së Prizrenit
OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga kërkesat e Lidhjes së Prizrenit

1 pikë Nëse shkruan një nga kërkesat e Lidhjes së Prizrenit

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 12**Model përgjigjeje**

- Komiteti Qendror i PKSH dhe Këshilli i përgjithshëm NACL arsyetonin se nëpërmjet kësaj marrëveshje Balli Kombëtar fitonte të drejta që nuk i takonin, pasi deri atëherë ai nuk ishte hedhur në luftë.
- Krijimi i Komitetit të Shpëtimit të Shqipërisë spostonte dhe zhvlerësonte Këshillin e Përgjithshëm NACL
- Ndikimi i udhëheqjes jugosllave, e cila dëshironte bashkimin e forcave politike të Jugosllavisë me ato të Shqipërisë dhe Kosovës.
- P.K.SH-ja nuk donte ta ndante pushtetin me forcat e tjera politike.

3 pikë Nëse shkruan tre nga arsyet e mosmarrëveshjes.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga arsyet e mosmarrëveshjes.

1 pikë Nëse shkruan një nga arsyet e mosmarrëveshjes.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 13**Model përgjigjeje**

- Anglia kishte një rrjet të dendur lumor që ndihmonte për transport.
- Gëzonte një pozicion të favorshëm në tregti.
- Pasuritë nëntokësore të shumta ishin baza për zhvillimin e industrisë.
- Para revolucionit industrial në Angli ishte kryer revolucioni agrar.
- Zotëronte koloni të shumta të cilat ishin të nevojshme për lëndën e parë dhe për tregje shitjeje të produkteve industriale.
- Në këtë shekull shumica e shpikjeve mbanin patentën angleze.
- Fisnikëria angleze nuk u bë pengesë për sipërmarrjen e lirë private. Një pjesë e tyre ngritën banka, investuan në industri, transport etj.
- Kishte gati një shekull e gjysmë që nuk ishte dëmtuar nga luftërat.
- Procesi i gardhimit në fshat çoi në migrimin e popullsisë fshatare drejt qytetit, duke rritur fuqinë punëtore.

3 pikë Nëse jep tri nga arsyet

OSE

2 pikë Nëse jep dy nga arsyet

1 pikë Nëse jep një nga arsyet

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 14**Model përgjigjeje**

- Gërmimet arkeologjike në trevat e banuara.
- Të dhënat gjuhësore (toponimet, emrat e njerëzve, burimet e shkruara etj.
- Vazhdimësia e jetës urbane.
- Të dhënat etnografike.

3 pikë Nëse liston tre prej të dhënave të vazhdimësisë etnokulturore

OSE

2 pikë Nëse liston dy prej të dhënave të vazhdimësisë etnokulturore

1 pikë Nëse liston një prej të dhënave të vazhdimësisë etnokulturore

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 15**Model përgjigjeje**

Bashkimi doganor

Unifikimi i monedhës

Komandë të përbashkët ushtarake

3 pikë Nëse shkruan tre nga marrëveshjet të cilat cënonin sovranitetin e shtetit shqiptar**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy nga marrëveshjet të cilat cënonin sovranitetin e shtetit shqiptar**1 pikë** Nëse shkruan një nga marrëveshjet të cilat cënonin sovranitetin e shtetit shqiptar**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare**Pyetja 16****Model përgjigjeje**

- PKSH

- Formën e regjimit të përcaktohej pas luftës, duke u mbështetur në vullnetin e popullit

- Çështja e Kosovës u vendos të zgjidhej pas lufte, sipas parimit të vetëvendosjes dhe Kartës së Atlantikut

3 pikë Nëse shkruan emrin e partisë dhe dy çështjet të cilat u menduan të zgjidheshin pas lufte.**OSE****2 pikë** Nëse shkruan emrin e partisë dhe një çështjet të cilat u menduan të zgjidheshin pas lufte **OSE** shkruan dy çështjet të cilat u menduan të zgjidheshin pas lufte.**1 pikë** Nëse shkruan emrin e partisë **OSE** një çështjet të cilat u menduan të zgjidheshin pas lufte**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 17****Model përgjigjeje**

a) Eliminuan ose kthyen ne formale institucionet e shtetit demokratik.

b) U shpërndanë partitë politike jo naziste.

c) U krijua kulti i udhëheqësit.

d) U ushtrua terror.

e) Edukimi dhe manipulimi i të rinjve dhe masave në përgjithësi.

f) Ruajtën pronën private dhe forcuan kontrollin shtetëror.

g) Ekonomia u orientua drejt prodhimit të armëve.

h) Antisemitizmi.

3 pikë Nëse shkruan tre nga tiparet e nazizmit.**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy nga tiparet e nazizmit.**1 pikë** Nëse shkruan një nga tiparet e nazizmit.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18**Model përgjigjeje**

- a) Sipas Paktit të Parë të Tiranës, Italia fitonte të drejtën të ndërhynte në Shqipëri në rast se cenohej statukuojat politike, juridike dhe tokësore e Shqipërisë.
Pakti i Dytë i Tiranës përcaktonte më konkretisht ndërhyrjen e Italisë në Shqipëri në rast lufte dhe agresioni të jashtëm.
- b) Qeveria shqiptare me këto pakte nuk ishte në pozita të barabarta, pasi Italia vendoste jo vetëm kontrollin politik por edhe atë ushtarak.

3 pikë Nëse shkruan të drejtat që fitonte Italia nëpërmjet dy pakteve dhe bën argumentimin e pozitës së Shqipërisë në këto pakte.

OSE

2 pikë Nëse shkruan të drejtat që fitonte Italia nëpërmjet dy pakteve **OSE** nëse shkruan të drejtat që fitonte Italia nëpërmjet njërit prej pakteve dhe bën argumentimin e pozitës së Shqipërisë në këto pakte.

1 pikë Nëse shkruan të drejtat që fitonte Italia nëpërmjet njërit prej pakteve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 19**Model përgjigjeje**

- a) Sanksionohej parimi i ndarjes së pushteteve.
- b) Garantohehin liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve.
- c) Pushteti Legjislativ i Senatit kishte kompetenca më të gjëra se “Këshilli i Lartë Ekzekutiv”.
- d) Përcaktohej karakteri laik i Shtetit.

3 pikë Nëse shkruan tre elementet përparimtarë të këtij Statuti.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga elementet përparimtarë të këtij Statuti.

1 pikë Nëse shkruan një nga elementet përparimtarë të këtij Statuti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20**Model përgjigjeje***Qëllimi:*

Të ruhej dhe të zgjerohet aleanca kundër fashizmit në periudhën pas luftës dhe t'i jepej fund politikave përçarëse me qëllim sigurimin e një epokë të re të paqes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Objektivat

- T'i jepej fund përdorimit të forcës ushtarake me përjashtim të rasteve për vetëmbrojtje kombëtare.
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare dhe atyre të shteteve duhet të bëhet me mjete paqësore.
- Të bashkëpunohet për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve.
- Të njihet dhe respektohet sovraniteti kombëtar dhe e drejta e kombeve për vetëvendosje.
- Të arrijë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën ekonomike, sociale, kulturore e shëndetësore.

3 pikë Nëse shkruan qëllimin e krijimit të OKB dhe dy nga objektivat e saj

OSE

2 pikë Nëse shkruan qëllimin e krijimit të OKB dhe një nga objektivat e saj **OSE** shkruan vetëm dy nga objektivat e OKB

1 pikë Nëse shkruan qëllimin e krijimit të OKB **OSE** një nga objektivat e saj

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare